



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUKËS

Nr. 734 Prot

Kukës, 12.08.2025

NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

Tema e konsultimit:

“Për miratimin e planit të arsimit parauniversitar 2026-2028 në bashkisë Kukës”

Propozuesi i konsultimit:

Këshilli Bashkiak /Kryetari i Bashkisë / Sekretari i Këshillit Bashkiak
/Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës

Informacion për konsultimin:

Në Këshillin Bashkiak është paraqitur projektvendimi “Për miratimin e planit të arsimit parauniversitar 2026-2028 në Bashkinë Kukës”. Ky plan synon përmirësimin e cilësisë në edukimin parauniversitar, zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe të aksesueshëm për fëmijët e nxënësit, rritjen e kapaciteteve të mësuesve dhe edukatorëve, sigurimin e infrastrukturës së sigurt dhe të përshtatshme, nxitjen e pjesëmarrjes së komunitetit dhe prindërve në vendimmarrjet arsimore, etj. Para shqyrtimit dhe miratimit të këtij plani, ftojme qytetarët, përfaqësuesit e institucioneve arsimore, organizatat e shoqërisë civile, prindërit, mësuesit dhe të gjithë aktorët e interesuar për të dhënë mendimet, sugjerimet, komentet dhe rekomandimet e tyre për një arsim cilësor dhe gjithpërfshirës në bashkinë tonë.

Vendi, koha e konsultimit:

Konsultimi do të organizohet ditën e premtë me datë 23.08.2025 ora 11⁰⁰ në ambjentet e pallatit të kulturës “Hasan Prishtina”.

Aktorët pjesëmarrës në konsultim:

Nga organizatorët:

Kryetari/Anëtarë të Këshillit Bashkiak/Sekretari i Këshillit Bashkiak,
Kryetari i Bashkisë/zv. Kryetarët, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës.

Nga të ftuarit:

Përfaqësues të institucioneve arsimore, organizatat e shoqërisë
civile, prindër, mësues, media dhe çdo të interesuar.

Forma e konsultimit:

Marrja e sugjerimeve dhe rekomandimeve nga të pranishmit në
konsultimin publik nëpërmjet diskutimeve, pyetjeve, komenteve.
Paraqitja e konkluzioneve të konsultimit bëhet në komisionin
përkatës dhe Këshillin e Bashkisë.

Me respekt,

Kryetari i Këshillit
Albert MUJA

